

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 101 nga Kushtetuta e RMV, nenit 37 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 39/12, 83/18, 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr. 96/19), neni 63 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.14/22), në Seancën e përgjithshme më 24.02.2022, miratoi:

PLOTËSIMIN
E QËNDRIMIT PARIMOR 03 Su.nr.335/21 të datës 28.04.2021

Në pikën 1 pas fjalëve “i ndërpritet ose është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit”, shtohen fjalët “ose i është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

Në pikën 2 pas fjalëve “Në rast të ndërprerjes ose shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

Në pikën 3 pas fjalëve “i nënshkruar nga gjyqtari referues, të cilit i është ndërprerë ose është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose i është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

Në pikën 4 pas fjalëve “nga gjyqtari referues, të cilit i është ndërprerë ose është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose i është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

Në pikën 5 pas fjalëve “dhe gjyqtarit referues si anëtar i këshillit në ndërkohë i është ndërprerë ose është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose i është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

Në pikën 6 pas fjalëve “Në rast të ndërprerjes ose shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

Në pikën 7 pas fjalëve “Në rast të ndërprerjes ose shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

Në pikën 8 pas fjalëve “Në rast të ndërprerjes ose shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

Në pikën 9 pas fjalëve “dhe nuk është miratuar vendim pas ndërprerjes ose shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose pas pezullimit të përcaktuar të funksionit të gjyqtarit të”.

Në pikën 10 pas fjalëve “Në rast të ndërprerjes ose shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit” shtohen fjalët “ose është përcaktuar pezullimi i funksionit të gjyqtarit”.

A r s y e t i m

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 28.04.2021, miratoi Qëndrim parimor lidhur me çështjen e mënyrës së veprimit me lëndë nga të gjitha sferat në rast të ndërprerjes së funksionit të gjyqtarit ose shkarkimit sipas nenit 73 dhe 74 të Ligjit për gjykatat, kryetarit ose anëtarit të këshillit, por nuk përfshiu edhe veprimin me lëndë në rast të pezullimit të funksionit të gjyqtarit sipas nenit 53 paragrafi 1 nga i njëjti Ligj.

Me miratimin e Qëndrimit parimor nga Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe me kërkesë të një gjyqtari të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për pezullimin e funksionit të gjyqtarit, Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi aktvendim, me të cilin përcaktoi pezullim të funksionit të gjyqtarit, për një gjyqtar të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me miratimin e aktvendimit të theksuar, u imponua domosdoshmëria e miratimit për plotësimin e Qëndrimit parimor të datës 28.04.2021, me të cilin u zgjidh çështja si të veprohet me lëndët për të cilat është vendosur ose është shqyrtuar, por nuk është miratuar vendim. Me miratimin e Qëndrimit parimor të datës 28.04.2021, nga pika 1 – 10 është vendosur për të gjitha çështjet si të veprohet për lëndë në rast të ndërprerjes ose shkarkimit të gjyqtarit nga funksioni i gjyqtarit, por nuk është vendosur edhe për situatën në rast të pezullimit të funksionit të gjyqtarit.

Për shkak të arsyeve të sipër theksuara, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 24.02.2022 pas mbarimit të seancës nxori Konkluzion për plotësimin e Qëndrimit parimor, që do të jetë pjesë përbërës i Qëndrimit parimor 03Su.nr.335/21 të datës 28.04.2021.

**SEANCA E PËRGJITHSHME E
GJYKATËS SUPREME TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

EW/